



**Prishtinë: 30.09.2011**

**Kodi i ZRRE-së: V\_371\_2011**

**Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_617\_06\_11**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_617\_06\_11**;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 18.07.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2011 nxori këtë:**

#### **VENDIM**

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Hylkije Mehdiu (parashtruesi i ankesës: Mirlinda Ajeti, shifra e konsumatorit DPR - 115364) nga Prishtina si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

#### **Arsyetim**

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 25.10.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 15.10.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së faturave nga periudha 10/1999 deri më 02/2009.

- Me datë 30.06.2003 konsumatori ka nënshkruar kontratën për ri programimin e borxhit me KEK sha në vlerë 1,600 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 19.05.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut, kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se konsumatori ka njehsorin elektrik nr. 001193 me bllomb shtetërore të këputur dhe pa bllomb distributive. Punëtorët e KEK-ut po ashtu kanë theksuar se konsumatori obligohet të bëjë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe se kanë vulosur (bllombuar) njehsorin elektrik me vulë distributive nr. A1004579. **Provë:** Procesverbali nr. 0141041 i datës 19.05.2008
- Me datë 29.01.2010 punëtorët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se konsumatori ka bërë ndërrim njehsori. **Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 062040 i datës 29.01.2010
- Me datë 18.02.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë bërë pranimin teknik të instalimit elektrik për njehsorin elektrik me nr. 9090729. **Provë:** Procesi i pranimit të instalimit elektrik nr. 006633 i datës 18.02.2010



- Me datë 20.03.2010 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 001193, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllobat) shtetërore i mungojnë, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka si dhe në brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi.  
**Provë:** Procesverbali me nr. 54/20 i datës 20.03.2010
- Punëtorët e autorizuar për shqyrtimin e njehsorëve elektrik në qendrën e kalibrimit kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr. 001193 ku kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar matës.  
**Provë:** Protokoll i mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr .008226
- Me datë 13.10.2010 KEK-u ka bërë korrigjimin e faturave për periudhën 07/2009 deri më 03/2010 në vlerë 110.29 €.  
**Provë:** Urdhër lejimi/ngarkimi nr. 288DPR-115364-115364 i datës 13.10.2010
- Me datë 23.09.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar borxhin e tërësishëm të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 15.10.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e shqyrtimit të njehsorit elektrik.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 15.10.2010
- Me datë 25.10.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 30.06.2011 DMK ka lëshuar një vendim duke refuzuar ankesën e konsumatorit si të pabazë.
- Me datë 18.07.2011 konsumatori ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_617\_06\_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: **ZRRE/DMK\_V\_617\_06\_11** të mbetet në fuqi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar